FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT: Informacion për përdoruesin

KLORUR BENZALKONI

Tretësirë – 5%, 10%

(Klorur benzalkoni)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Klorur benzalkoni dhe përse përdoret
2. Përpara se të përdorni Klorur benzalkoni
3. Si ta përdorni Klorur benzalkoni
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Klorur benzalkoni
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË KLORUR BENZALKONI DHE PËRSE PËRDORET

Kloruri i benzalkonit, si nje kripë e amoniumit kuaternar, është një antiseptik dhe dezinfektant me veprim të ngjashëm me atë të tensioaktivëve kationikë.

Klorur benzalkoni përdoret në dezinfektimin e:

- sipërfaqeve të ndryshme (dysheme, mure etj.);
- objekteve metalike;
- veglave kirurgjikale, kateterëve.

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI KLORUR BENZALKONI

Nuk ka një kundërindikacion absolut për Klorur benzalkoni, megjithatë për shkak të efekteve të tij korrozive dhe toksike duhet mbajtur larg fëmijëve dhe grave shtatzëna.

Tregoni kujdes të veçantë me Klorur benzalkoni

- Rekomandohet që gjatë përdorimit si dezinfektant të përdoren doreza dhe mbrojtëse për sytë.
- Klorur benzalkoni nuk duhet të përdoret për dezinfektimin e lenteve të buta të kontaktit.
- Duhet mbajtur larg fëmijëve dhe grave shtatzëna.

Marrja e barnave të tjera

Nuk ka të dhëna.

Shtatzënia dhe Ushqimi me gji

Kërkoni këshillën e mjekut ose të farmacistit përpara se të përdorni këtë produkt.
Ky produkt duhet mbajtur larg grave shtatzëna.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna.

3. SI TA PËRDORNI KLORUR BENZALKONI

Gjithmonë përdoreni Klorur benzalkoni ashtu si është përshkruar në fletëudhëzues. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin.

<u>Klorur benzalkoni – tretësirë 10%:</u>

- *Për dezinfektimin e sipërfaqeve të ndryshme (dysheme, mure etj):* 1 litër tretësirë hollohet me 500 litra ujë.
- *Për dezinfektimin e objekteve metalike:* 1 litër tretësirë hollohet me 100 litra ujë.
- *Për dezinfektimin e veglave kirurgjikale, kateterave etj:* 1 litër tretësirë hollohet me 50 litra ujë.

Klorur benzalkoni – tretësirë 5%:

Përdoret gjysma e sasive të mësipërme të ujit për hollim, në mënyrë që të arrihet i njëjti përqëndrim.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Gjatë përdorimit të Klorur benzalkoni mund të shfaqen acarime korrozive lokale të lëkurës ose nekrozë.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI KLORUR BENZALKONI

Mbajeni larg fëmijëve!

Mos e përdorni Klorur benzalkoni pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim!

Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!

Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Klorur benzalkoni – Tretësirë 10%

Lënda vepruese është klorur benzalkoni.

1 ml tretësirë përmban 0.1 g klorur benzalkoni.

Përbërësit e tjerë: alkool etilik, ujë i pastruar.

Çfarë përmban Klorur benzalkoni – Tretësirë 5%

Lënda vepruese është klorur benzalkoni.

1 ml tretësirë përmban 0.05 g klorur benzalkoni.

Përbërësit e tjerë: alkool etilik, ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit

Klorur benzalkoni – Tretësirë 10%: Shishe plastike me 50 ml, shishe plastike me 1000 ml.
Klorur benzalkoni – Tretësirë 5%: Shishe plastike me 1000 ml.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAH) dhe prodhuesi:
PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta "
Tel. 00355 4 23 89 602
Tiranë, Shqipëri

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Prill 2014.